



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti XI  
Nr.65  
Mars - Prill  
2014

## Asociacioni i Komunave të Kosovës takoi partnerët e qeverisjes lokale

AKK-ja organizoi takim me partnerët e saj në takimin “Miq të AKK-së” me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me partnerë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e qeverisjes lokale në Kosovë.



## Ministria e Financave u shkurton buxhetin komunave për 6.3 milion euro

Zvogëlimi në nivel prej 15% i buxhetit në komuna, në kategorinë për “Mallëra dhe shërbime” do të ketë impakt negativ në ofrimin e shërbimeve kualitative të cilat ofrohen nga komunat e Republikës së Kosovës dhe në zbatimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të autoriteteve lokale të cilat burojnë nga Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale.

## Pagat për stafin politik në komunat e Kosovës rriten për 25 për qind

Me këtë rritje, në pagat e tyre, do të përfitojnë kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Kjo rritje e pagave në shumën prej 25 për qind është e njëjta e cila është kërkuar edhe nga Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## Nga mbledhja e parë e Bordit të AKK-së pas zgjedhjes

Anëtarët e Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës debatuan lidhur me çështjen e stacioneve të autobusëve, problemet lidhur me asetet komunale, projektet e donatorëve ndërkombëtar lidhur me investimet në sistemin e ujit dhe kanalizimit, ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve komunal, çështjen e përfaqësimit të komunave në Bordet Rajonale të Ujit etj.



## Nga mbledhja e parë e Bordit të AKK-së pas zgjedhjes



Bordi i AKK-së mbajti takimin e parë pas zgjedhjes, në përbërjen: kryetari z.Naim Ismajli, nënkryetari i AKK-së, z.Agim Veliu dhe anëtarët e Bordit, z.Bajram Mulaku, z.Muharrem Sfarqa, z.Agron Kuçi dhe z.Gradimir Mikiç. Në këtë takim ishin prezent edhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z.Sazan Ibrahimimi dhe z.Arsim Osmani –Menaxher për Komunikim dhe Projekte i AKK-së.

Takimin e hapoi dhe e kryesoi kryetari z.Naim Ismajli

ku ai përgëzoi anëtarët e Bordit për përzgjedhjen duke iu dëshiruar suksese në përfaqësimin e komunave. Bordi në këtë takim miratoi Plani i Punës së AKK-së për vitin 2014 pas prezantimit të tij nga ana e Drejtorit Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi si dhe debatoi për angazhimet e strukturave të AKK-së në strategjinë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo strategji është debatuar edhe në 12 Kolegjiunet profesionale të AKK-së. Bordi në këtë takim pasi aprovoi buxhetin e Asociacionit të Komunave të Kosovës për vitin 2014 debatoi edhe lidhur me pagesën e anëtarësisë së komunave.

Poashtu anëtarët e Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës debatuan edhe lidhur me çështjen e stacioneve të autobusëve, problemet lidhur me asetet komunale, projektet e donatorëve ndërkombëtar lidhur me investimet në sistemin e ujit dhe kanalizimit, ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve komunal, çështjen e përfaqësimit të komunave në Bordet Rajonale të Ujit etj.

## Asociacioni i Komunave të Kosovës takoi partnerët e qeverisjes lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e rregullt me partnerët e saj në takimin “Miq të AKK-së” në Prishtinë, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me partnerë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e qeverisjes lokale në Kosovë.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e SDC-së, USAID/BEP-it, OSBE-së, Helvetas, OBSH-së, Asociacioni i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Norvegjisë, Amiqi Dei Bambini, KS-Kosova, UNICEF, NDI si dhe kryesuesit e Kolegjiunet Profesionale të AKK-së. Z. Sazan Ibrahimimi, Drejtor Ekzekutiv i AKK pas njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra për natyrën dhe qëllimin e takimit ku theksoi rolin e veçantë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët në projekte të ndryshme në interes të komunave bëri prezantimin e të arriturave dhe punës së deritanishme të AKK-së në vitet e fundit si dhe me planin vjetor për vitin 2014. Nga të gjithë pjesëmarrësit u paraqitën projekte e tyre

konkrete në fushat e ndryshme ku mund të ketë bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta së bashku me komunat në realizimin e objektivave të qarta të cilat kanë gjatë mandatit të tyre këto organizata. Sigurisht njëra ndër sfidat ende mbetet bashkëpunimi më i mirë nga donatorët në fusha të ndryshme gjatë zbatimit të projekteve të tyre andaj edhe bashkëveprimi i aktiviteteve duhet të jetë në funksion të organizimit sa më të mirë të punës, në mos dyfishimin e aktiviteteve dhe projekteve nga partnerë të ndryshëm. Po ashtu kërkua qasje më aktive dhe bashkëfinancim të projekteve në fjalë nga komunat lidhur me aktivitetet e përbashkëta në përmirësim të shërbimeve për qytetarët në fusha të ndryshme.

Kryesuesit e Kolegjiunet Profesionale e çmuan angazhimin e donatorëve në dhënie të ndihmës financiare dhe profesionale për komunat, po ashtu u shpreh përkrahja e fuqishme dhe bashkëpunimi i ngushtë nga Kolegjiunet Profesionale me donatorët sa i përket koordinimit të projekteve në fusha specifike, bashkërendimi i planeve të punës dhe aktiviteteve në zbatimin me sukses të tyre në teren.

Në këtë takim përfaqësuesit e të gjithë organizatave partnere të AKK-së në fushën e qeverisjes lokale në Kosovë u pajtuan që kur të përfundojnë projektet e organizatave, mjetet teknike të zyrave të tyre t'u dorëzohen komunave edhe si ndihmë për aktivitetet e e-qeverisjes.

## Nga ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

## Kërkesë për ngritjen e pagave/mëditjeve të stafit politik në Komuna

Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në mbledhjen e mbajtur me datën 21 mars 2014 (në përbërje: kryetari z. Naim Ismajli, nënkryetari i AKK-së, z. Agim Veliu dhe anëtarët e Bordit, z. Bajram Mulaku, Muharrem Sfarqa, Agron Kuçi dhe z. Gradimir Mikiç) diskutoi rreth mundësisë për ngritjen e pagave/mëditjeve për stafin politik në komunat e Kosovës.

Kështu, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) iu drejtohet me kërkesë Qeverisë së Kosovës për ngritje të pagave/mëditjeve për stafin politik në Komuna, pasi që e konsiderojmë si të domosdoshme dhe që kërkon trajtim të menjëhershëm.

AKK-ja ishte edhe pjesë e procesit të hartimit të Ligjit të Pagave të Funkionarëve Publik me të cilin do të rregullohej në mënyrë të duhur kjo çështje, por kjo nuk u realizua, andaj situata e krijuar, diferenca shumë e madhe e pagave mes nivelit qendror dhe nivelit lokal dhe anashkalimi i trajtimit të funksionarëve – respek-

tivisht pagave të tyre, kërkon ndërmarrjen e hapave tjerë me të cilët do të rregullohen pagat e stafit politik në nivel lokal.

Asociacioni i Komunave të Kosovës konsideron se ngritja e pagave/mëditjeve duhet të jetë në nivelin prej 25% sepse janë shumë faktorë që determinojnë nevojën e ngritjes së pagave/mëditjeve të stafit politik në Komuna në nivelin prej 25%, ndër to veçojmë:

Mos ngritja e pagave/mëditjeve të stafit politik në komuna që nga viti 2008;

- Ngritja e pagave dy herë për kategoritë tjera që nga viti 2008;

- Shtimi i kompetencave të komunave.

- Paga e drejtorit të një shkolle fillore dhe të mesme të menaxhuar nga Drejtoria Komunale për Arsim është më e madhe se e vetë Drejtorit Komunal për Arsim.

- Paga e drejtorit të Qendrës së Mjekësisë Familjare të menaxhuar nga Drejtoria Komunale për Shëndetësi është më e madhe se e vetë Drejtorit Komunal për Shëndetësi.

- Paga e zyrtarit komunal për Teknologji Informativ është më e lartë se e një drejtori komunal i cili e menaxhon këtë zyrtar dhe kjo pagë është shumë e përafërt në disa raste edhe me vetë pagën e kryetarit të komunës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës e ka bërë një analizë mbi implikimet financiare të ngritjes së pagave/mëditjeve të stafit politik në Komuna në nivelin prej 25%. Në bazë të kësaj, shuma totale e mjeteve të nevojshme për të realizuar një ngritje në këtë nivel është 1,000,050.00 €.

Asociacioni i Komunave të Kosovës shpreson në gatishmërinë e institucioneve qendrore për trajtimin e kësaj çështje, duke marrë vendimin e duhur për ngritjen e pagave/mëditjeve të funksionarëve publik të nivelit lokal në vlerën e lartë cekur, nga i cili vendim, si stimulim për punën dhe angazhimin priten rezultate konkrete, duke filluar që nga ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

## Pagat për stafin politik në komunat e Kosovës rriten për 25 për qind

Pas kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe lobimit të vazhdueshëm institucionet qendrore, kanë marrë vendim që pagat për stafin politik në komunat e Kosovës të rriten për 25 për qind.

Me këtë rritje, në pagat e tyre, do të përfitojnë kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Kjo rritje e pagave në

shumën prej 25 për qind është e njëjta e cila është kërkuar edhe nga Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Vlen të ceket se Asociacioni i Komunave të Kosovës në kërkesën dhe lobimin e përditshëm kishte argumentuar shumë qartë për arsyet e ngritjes së pagave për stafin politik në komunat e Republikës së Kosovës edhe duke faktuar në mënyrë tabelare

se me këtë rritje do të këtë efektivitet në shërbimet lokale ndërsa buxheti i shtetit nuk do të pësojë ndonjë ngarkesë të papërbalueshme e cila nuk tejkalon tani as një milion euro.

AKK-ja këtë e vlerëson edhe një arritje të saj në angazhimet për shërbime të përditshme për komunat e Republikës së Kosovës.



## E-Qeverisja në Kosovë

Nën organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe mbështetje të Asociacionit Norvegjez të Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Norvegjisë është mbajtur konferenca për "Statusin dhe të ardhmen e e-Qeverisjes Lokale në Kosovë", e cila është e organizuar për Kryetarët e Komunave dhe Drejtorët e Administratës të Komunave të Republikës së Kosovës.

Në këtë konferencë është prezantuar 'Statusi i Agjendës Dixhitale Lokale', pastaj 'Mundësitë dhe rekomandimet për qendrueshmërinë e projektit', 'Barrierat për e-Qeverisje në Komunitatet e Kosovës' dhe 'Formimi i Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit'.



## Ministria e Financave u shkurton buxhetin komunave për 6.3 milion euro

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) reagon ndaj Vendimit nr.07/172, datë 27.2.2014, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me kursimin e 15 % të shpenzimeve në kategorinë "Mallëra dhe Shërbime" të organizatave buxhetore për vitin 2014.

Nga ky vendim i Qeverisë së Kosovës, buxheti edhe ashtu i vogël i komunave të Republikës së Kosovës, zvogëlohet për rreth 6.3 milion euro.

Zvogëlimi në nivel prej 15% i shpenzimeve në komuna, në kategorinë për "Mallëra dhe shërbime" do të ketë impakt negativ në ofrimin e shërbimeve kualitative të cilat ofrohen nga komunitatet e Republikës së Kosovës dhe në zbatimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të autoriteteve lokale të cilat burojnë nga Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Asociacioni i Komunave të Kosovës vlerëson se nuk mund të bëhet në mënyrë lineare ky kursim, duke pasur parasysh se Komunitatet, vazhdimisht investojnë në projekte kapitale, të cilat paralelisht kanë shpenzime të vazhdueshme për mirëmbajtjen e objekteve ku ofrohen shërbimet elementare për qytetarët siç janë çerdhet, shkollat, qendrat e mjekësisë familjare etj.

Ne konsiderojmë se Vendimi si i tillë është marrë pa konsultim me autoritetet lokale, nuk janë njoftuar paraprakisht dhe nuk janë marrë parasysh rrethanat e nivelit lokal por vetëm rrethanat e nivelit qendror.

Zbatimi i këtij vendimi është në kundërshtim me parimet e Kartës së Vetëqeverisjes Lokale, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjeve tjera sektorale, nga cilat burojnë obligimet e komunave, që të ju ofrohen shërbime sa më të mira dhe më afër qytetarëve.

Ky vendim do të pengojë zhvillimin e aktiviteteve normale të autoriteteve lokale në ofrimin e kushteve sa më të mira për jetën e qytetarëve përmes shërbimeve të përditshme.

## Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor takohet me përfaqësues të MMPH-së

Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor të Asociacionit të Komunave të Kosovës mbajti takim të radhës me qëllim diskutimin e përbashkët me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për sqarime plotësuese lidhur me Ligjin për Ndërtim dhe Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Ilegale si kërkesë e dalë nga vetë Kolegjiumi duke marrë parasysh ndryshimin e madh të Drejtorëve të Drejtorive Komunale në zgjedhjet e fundit lokale. Edhe një herë komunitatet shprehën shqetësimet e tyre dhe ballafaqimin me sfidat e shumta, në mënyrë specifike në fushën e urbanizimit sikurse janë kushtet e ndërtimit dhe trajtimi i ndërtimeve pa leje. Gjatë takimit u ra dakord që të ketë trajtime shtesë për drejtorët e rinj komunal nga MMPH-ja në bashkëpunim me AKK-në lidhur me informimin e duhur të Ligjit për Ndërtim dhe Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje si dhe detyrimet komunale gjatë zbatimit të tyre në komuna.

Si përfundim i përbashkët ishte kërkesa që të ketë konsultime të vazhdueshme nga MMPH-ja, së bashku me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumin për Planifikim Hapësinor në përgatitjen dhe furnizimin e komunave me udhëzime administrative aq shumë të nevojshme në zbatimin e Ligjeve për Ndërtim dhe Trajtim të Ndërtimeve pa leje në eliminimin e çdo konfuzioni dhe pengesë gjatë implementimit të tij në terren.

## Vazhdon konsolidimi i Kolegjiumeve të AKK-së

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka vazhduar konsolidimin e kolegjiumve të saj. Kështu, në takimet e Kryesive të Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor, Kolegjiumit për Inspektion, Kolegjiumit për Administratë, Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave, Kolegjiumit për Shëndetësi, Kolegjiumit për IT, Kolegjiumit për Integritet Evropiane, Kolegjiumit për Buxhet dhe Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor janë hartuar draftet e planeve të punës për vitin 2014 të secilit Kolegjium të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në ndërkohë do të hartohen edhe planet e punës së Kolegjiumit për Arsim dhe Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik. Planet e punës së Kolegjiumeve janë udhërrëfyes të punës së tyre gjatë një viti ku adresohen projektligjet që janë në procedurë të miratimit apo ndryshimit si dhe çështjet që duhen trajtuar në fushën e kompetencave të kolegjiumeve përkatëse.

### Zgjedhet kryesuesi i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor

Në takimin e rradhës së Kryesisë së Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor të Asociacionit të Komunave të Kosovës është zgjedhur struktura udhëheqëse e këtij Kolegjiumi. Kështu, z. Liburn Aliu, Drejtor për Urbanizëm në Komunën e Prishtinës është zgjedhur Kryesues ndërsa z.Valon Shefkiu, Drejtor për Urbanizëm në Komunën e Gjilanit është zgjedhur Zëvendëskryesues i Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor të AKK-së. Në këtë takim është diskutuar edhe mbi Planin e Punës të këtij Kolegjiumi për vitin 2014 i cili do të miratohet në takimin e rradhës së Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor të AKK-së.

### Kryesia e Kolegjiumit për Shërbime Publike



Kryesia e Kolegjiumit për Shërbime Publike i Asociacionit të Komunave të Kosovës është takuar nën kryesimin e z. Ukë Selimaj. Në këtë takim është diskutuar plani i punës së Kolegjiumit për Shërbime Publike për vitin 2014. Planin e punës i këtij Kolegjiumi është paraparë të fokusohet në trajtimin e çështjeve problematike në sektorin e shërbimeve publike në Komunat sikurse janë menaxhimi i mbeturinave, deponive ilegale, çështja e stacionit të autobusëve etj. Në Planin e punës së Kolegjiumit për Shërbime Publike është paraparë edhe trajtimi i ndryshimeve në ligjet që bëjnë pjesë në Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014.

### Takohet Kryesia e Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave

Nën kryesimin e znj. Valentina Bunjaku-Rexhepi, është mbajtur takimi i parë i Kryesisë së Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në këtë takim është diskutuar dhe hartuar draft plani i punës së këtij Kolegjiumi për vitin 2014.



Krahas kësaj, Kryesia e Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave ka rekomanduar që në takimin e rradhës së Kolegjiumit të ftohen edhe përfaqësues të MAPL-së për të diskutuar mbi punën e Kuvendeve të Komunave dhe përmbushjen e obligimeve ligjore.



## Kolegjiumi për Shërbime Publike diskuton mbi legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave

Asociacioni i Komunave të Kosovës, me përkrahjen e programit MMS GIZ, ka organizuar një punëtori dy ditore për anëtarët e Kolegjiumit për Shërbime Publike në të cilën ka marrë pjesë edhe përfaqësues të kompanive regjionale për grumbullimin e mbeturinave. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik u kanë prezantuar drejtorëve të komunave për shërbime publike legjislacionin mbi menaxhimin e mbeturinave dhe legjislacioni mbi ndërmarrjet publike private. Krahas kësaj, përfaqësues të programit MMS GIZ kanë elaboruar modalitetet mbi caktimin nga ana e komunave të tarifave për grumbullimin e mbeturinave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Shkurtimisht

- Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me përkrahjen e GIZ kanë organizuar takim inicues të "Rrjetit komunal të shoqërisë civile". "Rrjeti komunal i shoqërisë civile" përbëhet nga organizata joqeveritare lokale i themeluar me qëllim të percjelljes dhe mbikqyrjes së përbushjes së agjendës pr integritet evropiane nga ana e komunave të Republikës së Kosovës.
- AKK-ja të gjitha Kolegjiumeve të drejtorive komunale, ua ka shpërndarë model aktet nënligjore që çdo komunë e ka obligim ligjor, me i hartuar dhe miratuar, me këtë rast AKK-ja ju ka ofruar komunave një produkt si alternative dhe lehtësim në punën e tyre.
- Kolegjiumi i Zyrtareve Ligjor i AKK-së i ka shqyrtuar dy udhëzimet administrative dhe i ka paraqitur vërejtjet dhe rekomandimet të cilat i ka dërguar në MAPL-në, ministri e cila i ka hartuar këto dy udhëzime administrative: Udhëzimin Administrativ për organizimin dhe funksionimin e komiteteve të obliguara në komunë dhe Udhëzimin Administrativ për organizimin e mbledhjes së kuvendit të komunës.

## Trajnime për Drejtorët Komunal për Administratë, Arsim dhe Shëndetësi lidhur me e-Qeverisjen në Komunitet e Kosovës

Organizuar nga Kolegjiumi për Administratë, Kolegjiumi për Arsim dhe Kolegjiumi për Shëndetësi të Asociacionit të Komunave të Kosovës, KS-Kosova dhe Asociacioni Norvegjez i Autoriteteve Lokale dhe Regjionale, drejtorët komunal për Arsim marrin pjesë në trajnime lidhur me e-Qeverisjen në Komunitet e Republikës së Kosovës. Këto trajnime, të cilat mbahet në Durrës të Shqipërisë, organizohen me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore për qeverisjen elektronike në komunat e Kosovës dhe është pjesë e projektit të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë.



## Mbahet Akademia për Efiqencën e Energjisë

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Bankën Gjermane (KFĒ), Shoqatën për Energji të Ripërtrishme (SHERK) dhe Asociacionin Kosovar për Energji të Ripërtrishme dhe Energji Efiqente (AKEREE) ka organizuar Akademi për Efiqencën e Energjisë me temën: Zhvillimi i

Efiqencës së Energjisë dhe burimeve të Ripërtrishme të Energjisë në nivelin lokal në Kosovë. Në këtë Akademi ku kanë prezantuar ekspertë për efiqencë të energjisë nga vendi dhe rajoni kanë marrë pjesë zyrtarët për energji të komunave dhe zyrtarë tjerë të drejtorive për shërbime publike të komunave. Qëllimi i organizimit të

Akademisë ishte prezantimi për zyrtarët e komunave komunal të koncepteve të efiqencës së energjisë, planeve të zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë si dhe janë diskutuar mundësitë për implementimin e këtyre masave për të mundësuar përdorimin e burimeve alternative të energjisë si elemente kyçe për ruajtjen e energjisë dhe për zhvillim ekonomik të komunave.

- AKK-ja për mes Kryesisë së Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, ka hartuar Dokumentin: “Procedura për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (Komentar)”, i cili dokument do të jetë në diskutim me Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjor, pastaj do të përkthehet dhe do të ju shpërndahet të gjitha komunave dhe do të ju shërbejë të gjithë anëtarëve të Kuvendeve të Komunës, zyrtarëve ligjor zyrtarëve të pronës dhe zyrtarëve tjerë.

- AKK përmes Kolegjiut të Arsimit e ka shqyrtuar Udhëzimin administrativ për Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, dhe me ndryshimet e propozimet e drejtorëve komunal të arsimit, MASHT ka nxjerr UA Numër: 08/ 2014, me të cilin inkurajonë mësimdhënësit që të konkurojnë për pozitat udhëheqëse në institucionet edukative dhe aftësuese duke iu ruajtur atyre vendet e mëparshëm të punës, si dhe rizgjedhja e drejtorëve të shkollës të bëhet sipas vlerësimit të performacës në punë.

- 10-11 Prill 2014, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë – Kryetari i AKK-së z. Naim Ismajli, Zëvendës Kryetari i AKK-së Z. Agim Veliu dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahim i kanë marrë pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm të NALAS-it, ku kryetari i AKK-së z. Naim Ismajli është zgjedhur edhe nënkryetar i radhës i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore).

- AKK-ja, po shqyrton me mekanizmin e saj Kolegjiutin e Planifikimit Hapësinor- Draftin fillestar të Projekt Udhëzimit Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.2005/9 për dhënien e pëlqimit për kyçje në rrugët Nacionale dhe Rajonale dhe Drafti fillestar të projekt i Udhëzimit Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.2004/5 dhe 2005/13 për caktimin e tarifave për kyçje në rrugë dhe Shfrytëzimin e tokës e cila i takon rrugës Nacionale dhe Rajonal.

## Shkurtimisht

- Asociacioni i Komunave të Kosovës mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit të Komisionit Evropian “Mbështetje për Ministrinë e Financave”. Në këtë takim u diskutua mbi statusin e projektit dhe mbi fushat të cilat duhet të jenë në fokus të përkrahjes gjatë periudhës së implementimit të saj. Pos tjerash, Projekti i KE-së “Mbështetje për Ministrinë e Financave” synon të përkrahë procesin e decentralizimit fiskal në Kosovë.

- Asociacioni i Komunave të Kosovës ka ftuar Drejtorët e Kolegjiut të Shërbimeve Publike të marrin pjesë në punëtorinë dy ditore e cila është mundësuar me mbështetjen e GIZ - MMS. Temat e diskutimit janë Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ligji për Shërbime Publike dhe Avancimi i Punës së Kolegjiut të Shërbimeve Publike. Për këtë arsye, përveç pjesëmarrjes së Drejtorëve Komunal në seminar, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe përfaqësues të kompanive publike për menaxhimin e mbeturinave ishin të ftuar gjithashtu.

- Programi trajnues “Talk On” mbi zhvillimin e kapaciteteve për udhëheqje, bashkëpunim dhe komunikim i mbështetur nga Programi GIZ CDBE që përfshinë Drejtorët Komunal të Arsimit dhe personelin e DKA-ve në pilot komunitet e përzgjedhura si nismëtare të programit trajnues si Prizren, Fushë-Kosovë, Klinë, Graçanicë, Kacanik, Skenderaj, Pejë, Podujevë, Gjiilan dhe Prishtinë, si dhe personelin e nivelit të lartë dhe të mesëm menaxhues, nga në MASHT-i, Më 28 -29 Mars 2014 në Istog, vazhdoj pjesën e bllokut të dytë të trajnimit dy ditorë në: Udhëheqje, Bashkëpunim & Komunikim.



## FOTO LAJM



### Vizitat e Kryetarit dhe Drejtorit të AKK-së në komuna

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi kanë nisur vizitat në komunitat e Republikës së Kosovës. Në këto takime kryetari Ismajli dhe drejtori Ibrahimimi po takohen me kryetarët e komunave dhe stafin e tyre. Në këto takime po bisedohet për sfidat aktuale të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës dhe mënyrat dhe shërbimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës për anëtarët e saj, komunitat e Republikës së Kosovës.



### ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti XI. Nr. 65 • Mars - Prill 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

